



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më datë 08.09.2022

VENDIM
Nr. 86, datë 08.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.04.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të sondazheve arkeologjike të përgatitur nga subjekti i licencuar në arkeologji, z. Ols Lafe, në kuadër të projektit “Banesë individuale 3 kate (Rindërtim)”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike B të Durrësit, me aplikues Almir Mane dhe zhvillues Erion Gega;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për kryerjen e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “Banesë individuale 3 kate (Rindërtim)”, brenda Kufirit Zonë Arkeologjike B të Durrësit;
3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

